

VENDIM

Nr. 628, datë 15.7.2015

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TEKNIKE TË PROJEKTIMIT DHE NDËRTIMIT TË RRUGËVE

(Ndryshuar me VKM nr. 111, datë 10.2.2016)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 18, të ligjit nr.8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.107/2014, “Për planifikimin e territorit”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

(Shtuar pika 1.1 me VKM nr. 111, datë 10.2.2016)

1. Miratimin e Rregullit Teknik për Projektimin e Rrugëve (RrTPRr), vëllimet nga nr.1 deri në nr.7, dhe të Rregullit Teknik për Ndërtimin e Rrugëve (RrTNRr), vëllimet nga nr.1 deri në nr.8

1.1. Përjashtimisht, për projektet që, para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë përfunduar, janë paraqitur për miratim apo janë miratuar termat e referencës, si dhe kur është kryer studimi i fizibilitetit, për projektimin dhe zbatimin e tyre deri në përfundim të zbatohen dispozitat e vendimit nr.68, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, që kanë qenë në fuqi para hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

2. Në lidhjen nr.2, bashkëlidhur vendimit nr.68, datë 15.2.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e standardeve dhe të kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, në “Kushtet teknike të projektimit” shfuqizohen pikat me numër rendor 21, 22, 26, 30, 31, 35, 36, 48, 59, 60, 61, 62 dhe 64; dhe në “Kushtet e zbatimit” shfuqizohen pikat me numër rendor 2, 3, 6, 8, 14, 21, 22, 23, 25, 39, 40, 41, 42, 46, 50, 51, 53, 54, 58, 60, 72, 74, 75 dhe 78.

3. Ngarkohen Instituti i Transportit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar që të përditësojnë, në vazhdimësi, Rregullin Teknik të Projektimit të Rrugëve (RrTPRr) dhe Rregullin Teknik të Ndërtimit të Rrugëve (RrTNRr).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama